




KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a.

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Mandati Mbështetës

Programi Mbështetës për Furnizim me Ujë dhe Kanalizime në Zonat Rurale – Faza VI

Mbështetja e Ekspertit për Autoritetin Rregullator të Shërbimeve të Ujit dhe Kompanitë
Regjionale të Ujit në Kosovë

ID E PUNIMIT: D11

TETOR 2018

UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E BORXHEVE NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE.....	2
2. RISHIKIMI I RREGULLIMIT INSTITUCIONAL TË BORXHEVE	3
2.1 Baza Ligjore	3
2.2 Menaxhimi i borxheve nga KRU.....	7
3. REKOMANDIMET E PËRGJITSHME DHE MONITORIMI.....	8
3.1 Rekomandime	8
3.2 Monitorimi (inspektimi) i përmbushjes së rekomandimeve nga KRU.....	9
POLITIKAT DHE PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN E BORXHEVE TË KRU “ <i>Inserto Emrin e kompanisë</i> ”	11
1. HYRJE.....	12
2. ZBATUESHMËRIA.....	12
3. DEFENICIONET.....	13
4. PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN E BORXHEVE	13
5. PROVIZIONIMI (LEJIMI) I BORXHEVE TË KËQJJA	19

1. HYRJE

Ky dokument, i cili do të shërbejë si Udhëzues për Menaxhimin e Borxheve në Sektorin e Shërbimeve të Ujit, i dedikohet mbështetjes dhërië shtatë Kompanive Regjionale të Ujit në Kosovë.

Udhëzuesi është hartuar në kuadër të Projektit “Mbështetja e Ekspertit për Autoritetin Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU) dhe Kompanitë Regjionale të Ujit në Kosovë (KRU)”, si pjesë e “Programit Mbështetës për Furnizim me Ujë dhe Kanalizime në Zonat Rurale – Faza VI” të financuar nga Agjensioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim, menaxhuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, dhe implementuar nga ‘Skat/OIKOS consultancy’. Ky dokument përbën Punimin ID.: D11 të Projektit.

Një nga qëllimet kryesore të këtij Udhëzuesi është të i’u sigurojë KRU sqarime në lidhje me politikat dhe legjislacionin vendor sa i përket menaxhimit të borxheve të këqija si dhe njohjes së tyre si shpenzime; si dhe politikave dhe kërkesave të ARRU për menaxhimin e mbledhjes së borxheve (sipas dy kategorive: borxhet më të vjetra se 24 muaj dhe ato deri në 24 muaj).

Hartimi i këtij Udhëzuesi është inicuar nga ARRU.

Autorja falenderon stafin e ARRU dhe KRU për bashkëpunim gjatë hartimit të këtij Udhëzuesi. Poashtu falenderon edhe Z. Sami Salihu, për sqarimet e siguruara në lidhje me dykuptimësinë e legjislacionit si dhe sqarime tjera lidhur me njohjen e borxheve të këqija si shpenzim.

Ky Udhëzues, përveç Hyrjes (Pjesa 1), përbëhet edhe nga 3 pjesë tjera:

- Pjesa 2: Rishikimi i rregullimit institucional të borxheve.
Kjo pjesë prezanton rezultatet e rishikimit të kornizës ligjore dhe praktikave zbatuese lidhur me menaxhimin e borxheve.
- Pjesa 3: Rekomandimet e përgjithshme dhe monitorimi
Kjo pjesë siguron rekomandimet për përmirësimet e mundshme në legjislacionin primar dhe sekondar si dhe në praktikën e aplikuar nga KRU për një menaxhim më efektiv të borxheve.
- **Pjesa 4: Politikat dhe Procedurat për Menaxhimin e Borxheve në KRU**
Kjo pjesë i dedikohet drejtpërdrejtë KRU. Nga secila KRU kërkohet të përvetësojë këtë pjesë të dokumentit, d.m.th. politikat/procedurat, duke insertuar brenda saj të dhënat e veta përkatëse si dhe informacionet tjera shtesë, sipas nevojës.

Ky Udhëzues është finalizuar pas komenteve të pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, stafi i ARRU dhe KRU si dhe pas diskutimeve të zhvilluara me stafin e ARRU dhe KRU në Takimin e punës të organizuar nga Projekti Mbështetës në bashkëpunim me ARRU në Prill 2018.

2. RISHIKIMI I RREGULLIMIT INSTITUCIONAL TË BORXHEVE

2.1 Baza Ligjore

Baza ligjore që rregullon çështjen e borxheve të këqija nga **aspekti i njohjes së tyre si shpenzime** (rrjedhimisht edhe për nevoja të TVSH) nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), buron nga dy ligje dhe një udhëzues administrativ:

- Ligji Nr. 05/L-029, për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 24 / 18 Gusht 2015, Prishtinë);
- Ligji Nr. 05/L-037, për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 23 / 17 Gusht 2015, Prishtinë);
- Udhëzimi Administrativ Mf-Nr. 02/2016, për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Ndërsa baza ligjore që rregullon çështjen e borxheve të këqija nga **aspekti rregullator i njohjes së tyre si shpenzime** nga ARRU, buron nga dokumenti për Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, lëshuar nga ARRU.

Sa i përket **mënyrës së llogaritjes, regjistrimit në kontabilitet të lejimit të llogarive të arkëtueshme**, kjo rregullohet përmes Standardeve Kosovare të Kontabilitetit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të aplikueshme në Kosovë.

Ndërsa sa i përket **marrjes së masave kundrejt konsumatorëve borxhlinj**, përveç legjislacionit të përmendur më lartë duhet të merren parasysh edhe Ligji Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, neni 28 dhe neni 35; dhe Rregulla për Kartën e Konsumatorit, neni 8 dhe neni 30.

Me qëllim të sqarimit të dykuptimisë për sa i përket rregullimit të borxheve të këqija nga aspekti i njohjes së tyre si shpenzime nga ATK, gjegjësisht pikën 3.1 të nenit 12 të Ligjit Nr. 05/L-029 dhe pikën 6.1 të nenit 43 të Ligjit Nr. 05/L-037; dhe me qëllim të kuptimit të drejtë të legjislacionit përkatës, Konsulentja ka dhënë interpretim të përmbledhur procedural të pikave 1-3 të nenit 12 të Ligjit bazë për rregullimin e kësaj çështje (d.m.th. Ligjit Nr. 05/L 029).

Në kornizën në vijim është siguruar versioni original i pikave 1-3 të nenit 12.

LIGJI NR. 05/L -029, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE;

INTERPRETIMI DHE PËRSHTATJA E PIKAVE 1-3 TË NENIT 12: SHPENZIMET E BORXHIT TË KEQ PËR SEKTORIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

Që një borxh i paarkëtuar të njihet nga ATK (dhe ARRU) si shpenzim i borxhit të keq duhet të merren parasysh interpretimet e poshtë shënuara:

- Së pari KRU duhet të sigurohen që kanë kontratë shërbimi me të gjithë konsumatorët që pranojnë shërbime; të i dërgojnë faturën rregullisht atyre dhe se vlerën e faturës të e kenë kontuar si të ardhur në kohën e ndodhjes së saj; poashtu KRU duhet të sigurohen se kanë përdatësuar databazën e konsumatorit me të dhënat e nevojshme personale të konsumatorit si dhe të dhënat lidhur me lidhjen;
- Nëse një pagesë nuk është arkëtuar plotësisht apo pjesërisht për ndonjë shërbim të kryer nga KRU, KRU e fillon procedurën për t'a shpallur atë borxh të keq. Mirëpo kjo procedurë shpallet vetëm për borxhet kur data e obligimit për pagesë të saj e ka tejkaluar afatin prej 6 muajsh por nuk e ka tejkaluar afatin prej 24 muajsh. Kjo nënkulon se KRU mund të fillojë procedurën edhe për borxhet e vitit paraprak por me kusht që të e kryejë të tërë procedurën deri në afatin kur borxhi në fjalë i mbush 24 muaj nga data e obligimit për pagesë.
- Shpallja e borxhit të keq vlen nën kushtin që në mes të KRU dhe konsumatorit të mos ketë ndonjë kontest të hapur për vlerën apo vlefshmërinë juridike të borxhit. Kontest i hapur nënkuptohet intervali nga pranimi i ankesës së konsumatorit nga KRU e deri tek zgjidhja përfundimtare e ankesës, qoftë kjo deri në shkallën e tretë të trajtimit të ankesës. Në rast se kontesti ka përfunduar me rezultatin se konsumatori duhet të paguajë mirëpo përkudër marrjes së të gjitha masave përcjellëse konsumatori prapë nuk ka paguar, atëherë ky borxh shpallet borxh i keq dhe pasqyrohet në periudhën fiskale / tatimore kur është shpallur si i tillë. Në rast se gjykata kompetente nuk ka arritur të e zgjidh kontestin në mes palëve (d.m.th. KRU dhe konsumatorit), brenda intervalit kohor të caktuar me ligj, atëherë lënda parashkruhet dhe në këtë rast KRU ka të drejtë të e shlyejë borxhin (kuptohet që gjithmonë respektohet afati prej 24 muaj nga data e obligimit për pagesë).
- Procedura për të shpallur një borxh si të keq përfshinë:
 - (i) marrjen e të gjitha masave të mundshme ligjore kundrejt borxhliut në periudhën e caktuar kohore prej 24 muajve. Masat e mundshme për një KRU, të shkallëzuara sipas koston më të ulët/përfitimit më të shpejtë janë:
 - 1) Dërgimi i vërejtjes së parë (që është pjesë e faturës së parë);
 - 2) Dërgimi i vërejtjes së dytë;
 - 3) Takimet sqaruese / komunikimet përmes mjeteve të ndryshme komunikuese (tel; e-mail; mediat; etj.);

LIGJI NR. 05/L -029, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE;

INTERPRETIMI DHE PËRSHTATJA E PIKAVE 1-3 TË NENIT 12: SHPENZIMET E BORXHIT TË KEQ PËR SEKTORIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

- 4) Ofrimi dhe lidhja e marrëveshjes për pagesë (marrëveshje e lidhur ndërmjet KRU dhe konsumatorit për pagesë të borxhit që ka konsumatori ndaj KRU);
- 5) Ndërprerja e përkohshme e lidhjes (sipas procedurave të brendshme);
- 6) Inicimi i procedurës përmbartimore;
- 7) Inicimi në organet gjyqësore (mund të mos aplikohet për borxhet më të ulta se 500 EUR);
- 8) Për rastet kur një konsumator (person juridik) është në proces të falimentimit, atëherë KRU e dërgon kërkesën për pagesën e borxhit dhe shuma e paguar njihet si e ardhur ndërsa shuma e mbetur e pa-paguar njihet si borxh i keq. Nëse nuk dërgohet kërkesa në fjalë tek kompania likuiduese, ose edhe nuk merren masat tjera të lartë përmendura, atëherë KRU rrezikon që të mos i njihet borxhi i këtij konsumatori si borxh i keq.

(ii) posedimi i evidencave të mjaftueshme se janë marr masat e përmendura në pikën (i). Evidencat përfshijnë:

- a) Kopjen e faturës / vërejtjes së parë;
- b) Kopjen e vërejtjes së dytë;
- c) Dëshmitë e komunikimeve;
- d) Dëshmitë imazhinare (fotot) dhe proces-verbalin e kryerjes së ndërprerjes së lidhjes, kjo e fundit të jetë e nënshkruar edhe nga borxhliu/konsumatori;
- e) Marrëveshjen për pagesë;
- f) Vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente ose Konkluzionin për mbylljen e procedurës së përmbartimit, që vërtetojnë se borxhi është i (pa) mbledhshëm;
- g) Çertifikatën nga policia, ose agjencionet e tjera të zbatimit të ligjit për të provuar se borxhliu nuk ka gjurmë;
- h) Çertifikatën e Zyrës Civile që dëshmon se borxhliu ka vdekur (kjo vlen për rastet kur nuk ka evidenca që prona e borxhliut / konsumatorit nuk trashëgohet bashkë edhe me obligimet e tij/saj nga dikush tjetër;
- i) Konfirmimin nga kompania likuiduese për shumën e borxhit e cila nuk mund të paguhet.

- Pasi që të jenë plotësuar kushtet e lartë cekura KRU mund të shpall borxhin e pambledhshëm si borxh i keq. Në këtë rast, KRU:

- lëshon një faturë të borxhit të keq, në të cilën shënohet "borxh i keq", vlerat përkatëse që korrigjohen, numrin rendor, nr. serik, datën e faturës së furnizimit me të cilën lidhet ky borxh. Kjo faturë përdoret nga KRU për të zvogëluar të ardhurën ndërsa nga konsumatori për të zvogëluar shpenzimin;
- "shlyen" borxhet e këqija nga evidencat e saja kontabël; d.m.th. bën një rregullim në

LIGJI NR. 05/L -029, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE;

INTERPRETIMI DHE PËRSHTATJA E PIKAVE 1-3 TË NENIT 12: SHPENZIMET E BORXHIT TË KEQ PËR SEKTORIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

librat e veta kontabël për të reflektuar uljen e vlerës së llogarive të arkëtueshme si dhe për të pasqyruar shpenzimin aktual të borxhit të keq. Si sqarim shtesë: gjithmonë borxhi i keq regjistrohet dhe pasqyrohet në periudhën fiskale / tatimore kur është pranuar/shpallur si i tillë (d.m.th. jo për periudhën kur është njohur si e ardhur).

- Në rast se borxhi i keq që është zbritur si shpenzim, është arkëtuar më vonë, atëherë shumat korresponduese duhet të përfshihen në të ardhurat e KRU në periudhën fiskale / tatimore në të cilën është bërë arkëtimi.

2.2 Menaxhimi i borxheve nga KRU

Siç është mësuar nga takimet me 7 KRU, të mbajtuara gjatë muajit Janar – Shkurt 2018, KRU kanë pohuar se kanë politika/procedura të shkruara për arkëtimin e të ardhurave mirëpo jo edhe për menaxhimin e borxheve sipas vjetërsisë.

Të gjitha KRU, në përgjithësi, bëjnë përpjekje të vazhdueshme për arkëtimin e borxheve të vjetra, por jo në mënyrë sistematike dhe për të gjithë konsumatorët ashtu siç kërkohet me legjislacionin përkatës. Poashtu në përgjithësi KRU nuk i kanë kushtuar kujdes krijimit të një dosjeje¹ të mirëfilltë që do të dëshmonte para palëve tjera ndjekjen e procedurave ligjore për mbledhjen e borxheve nga konsumatorët e tyre. Poashtu këto aktivitete rrallë herë janë përcjellur me kampanja të ndërgjegjësimit.

Në shumicën e rasteve KRU ende nuk kanë arritur të nënshkruajnë kontratë shërbimi me konsumatorët e tyre, **gjë që e pengon direkt atë të zbatojë procedurat ligjore të arkëtimit të borxheve.**

Poashtu edhe nga prespektiva e gjyqësorit, KRU nuk janë të kujdesshme në kompletimin e lëndëve, gjë që ndikon në zgjatjen e kohës së zgjidhjes së kontestit.

KRU, në shumicën e rasteve, nuk janë të njoftuar plotësisht me bazën e ligjore që rregullon çështjen e borxhit të keq.

Databaza e konsumatorëve, në përgjithësi, nuk përdatësohet rregullisht, gjë që e vështirëson mënyrën e komunikimit me konsumatorët e pa-përgjegjshëm.

¹ Dosja në këtë rast nënkupton grumbullin e dokumenteve që përdoren si dëshmi për marrjen e masave ndaj një konsumatori borxhlinj. Sugjerohet që dosja të jetë elektronike.

3. REKOMANDIMET E PËRGJITSHME DHE MONITORIMI

3.1 Rekomandime

ARRU gjatë proceseve të ardhshme të përcaktimit të tarifave për 7 KRU duhet të merr parasysh përqindjen e lejimit për borxhin e keq, duke u bazuar në (i) historinë e vitit paraprak (vitit bazë) të njohjes së borxhit të keq si shpenzim, e cila e dhënë agreguese do të burojë nga 'dosja e menaxhimit të borxheve të këqija', e cila dëshmohet se është krijuar duke e ndjekur 'Procedurën për trajtimin e borxheve të vjetra deri në 24 muaj' të propozuar në këtë dokument; si dhe në (ii) 'dosjen e menaxhimit të borxheve të vjetra', e cila dëshmohet se është krijuar duke e ndjekur 'Procedurën për trajtimin e borxheve më të vjetra se 24 muaj, të propozuar poshtu në këtë dokument. Poashtu ARRU do të e shfrytëzojnë 'dosjen e menaxhimit të borxheve të këqija' të 7 KRU edhe gjatë procesit të monitorimit/vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara për vitin që korrespondon me të dhënat nga dosja.

Në të njëjtin kohë, rekomandohen KRU që të e shfrytëzojnë pikën (i) të paragrafit më lartë gjatë përllogaritjes së provizionimit (lejimit) për borxhet e këqija, për nevojat e tyre të kontabilitetit financiar dhe menaxherial. Kjo nënkupton që si ARRU ashtu dhe KRU do të shfrytëzojnë të njëjtin parim gjatë përllogaritjes së borxheve të këqija për periudhat planifikuese.

KRU rekomandohen që të e krijojnë (dhe të e ruajnë) nga një 'dosje' për secilin konsumatorë të atakuar si borxhli i keq dhe ndaj të cilit janë marrë masa. Kjo vlen për të dy kategoritë e borxheve edhe atyre (i) me borxhe më të vjetra se 24 muaj; dhe (ii) të vjetra deri në 24 muaj. Dosjet duhet të mbahen ashtu që të dhënat të jenë lehtë të sortueshme/filtrueshme sipas dy kategorive të lartë përmendura dhe sipas viteve fiskale (kjo e fundit vlen vetëm për kategorinë e borxheve deri në 24 muaj). Kostoja e shlyerjes së borxheve, do të njihet si e tillë për qëllime të përcaktimit të tarifave, mirëpo pasi që ARRU sigurohet se janë duke u ndërmarr hapa të arsyeshëm nga KRU që do të sigurojnë se borxhet janë duke u trajtuar në mënyrë të duhur (d.m.th. sipas procedurës).

Shuma e mbledhjes së borxheve të cilat nuk i takojnë të njëjtit vit fiskal do të duhej të shfrytëzoheshin nga KRU për investimet të cilat kanë ngelur pa u bërë ("back log") si pasojë e mos arkëtimit të shumës së planifikuar të të ardhurave.

Poashtu rekomandohet që KRU të bëjnë të mundur ndarjen e pagesave të borxhit në Modulin e Faturimit, për periudhën e tanishme dhe atë paraprake, me qëllim që të dihet më saktë vjetërsia e borxheve.

KRU duhet urgjent të i nënshkruajnë kontratat me të gjithë konsumatorët pasi që në mungesë të tyre nuk mund të marrin asnjë masë ligjore përfshirë edhe masat e parapara me Ligjin për ARRU dhe Rregulloret e lëshuara nga ARRU. Poashtu duhet të përdatësojnë

databazën e konsumatorit me të dhënat e nevojshme personale të konsumatorit si dhe të dhënat lidhur me lidhjen (pikën faturuese).

Qeverisë së Kosovës i rekomandohet që të sqarojë dykuptimësinë në dy ligjet respektive, gjegjësisht pikën 3.1 të nenit 12 të Ligjit Nr. 05/L -029 dhe pikën 6.1 të nenit 43 të Ligjit Nr. 05/L -037. Po ashtu me qëllim të kuptimit të drejtë të të gjitha pikave 1-3 të nenit 12 të të Ligjit Nr. 05/L -029 rekomandohet Qeveria e Kosovës /Ministria e Financave që të rishikojë Udhëzuesin Administrativ Mf-Nr. 02/2016, për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, nenin 15, ashtu që të shtojë interpretime / sqarime shtesë për sa i përket rregullimit të “shpenzimeve të borxhit të keq” - me theks të veçantë të sqarimit të pikave 1.5.1; 1.5.3; 3.2; të nenit 12 të Ligjit Nr. 05/L -029.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në kryerjen e shërbimeve rekomandohen KRU që të pavarësojnë funksionin e shërbimit me konsumatorë ndaj atij të financave. Ndërsa, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtim dhe zvogëlimit të keqpërdorimeve të parasë së gatshme nga stafi për arkëtim (Inkasantët) rekomandohet që të zëvendësohet gradualisht metoda tashmë e vjetër e arkëtimit të të ardhurave ‘derë më derë’ me metodat e reja të pagesës përmes bankës dhe instrumenteve tjera moderne.

3.2 Monitorimi (inspektimi) i përmbushjes së rekomandimeve nga KRU

Projekti Mbështetës së bashku me ARRU do të monitorojnë (inspektojnë) përmbushjen e rekomandimeve nga 7 KRU të siguruara në këtë dokument në nën-kapitullin 2.3.

Draft forma e monitorimit është siguruar në vijim:

Përshkrimi i veprimit (nga rekomandimi)	Koha e monitorimit	Kompania	Komente
Progresi i përdatësimit të databazës	Qershor 2018 Dhjetor 2018	KRU Prishtina KRU Hidroregjioni Jugor KRU Hidrodrini KRU Gjakova KRU Mitrovica KRU Bifurkacioni KRJ Hidromorava	
Progresi i nënshkrimit të kontratave	Qershor 2018 Dhjetor 2018	KRU Prishtina KRU Hidroregjioni Jugor KRU Hidrodrini KRU Gjakova KRU Mitrovica	

Përshkrimi i veprimit (nga rekomandimi)	Koha e monitorimit	Kompania	Komente
		KRU Bifurkacioni KRU Hidromorava	
Progresi në krijimin e dosjes së menaxhimit të borxheve të këqija	Qershor 2018 Shtator 2018 Dhjetor 2018	KRU Prishtina KRU Hidroregjioni Jugor KRU Hidrodrini KRU Gjakova KRU Mitrovica KRU Bifurkacioni KRU Hidromorava	
Ndarja sipas vjetërsisë e pagesave të borxhit në Modulin e Faturimit	Qershor 2018	KRU Prishtina KRU Hidroregjioni Jugor KRU Hidrodrini KRU Gjakova KRU Mitrovica KRU Bifurkacioni KRU Hidromorava	
Pavarësimi i funksionit të shërbimit me konsumatorë ndaj atij të financave	Shtator 2018	KRU Prishtina KRU Hidroregjioni Jugor KRU Hidrodrini KRU Gjakova KRU Mitrovica KRU Bifurkacioni KRU Hidromorava	
Progresi i kalimit gradual në metodat e avancuara të arkëtimit të të ardhurave	Qershor 2018 Dhjetor 2018	KRU Prishtina KRU Hidroregjioni Jugor KRU Hidrodrini KRU Gjakova KRU Mitrovica KRU Bifurkacioni KRU Hidromorava	

1. HYRJE

Në kuadër të menaxhimit të burimeve tona financiare, KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a. ka siguruar përgatitjen e procedurave më të efektshme të mbledhjes së parasë dhe është gjithmonë e gatshme të sigurojë dëshmitë e mjaftueshme të përndjekjes së këtyre procedurave.

Konsumatorët e KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a. jo gjithmonë paguajnë për shërbimet që kanë përdorur. Nëse, përkundër përpjekjeve më të mëdha për mbledhjen e të ardhurave të papaguara konsiderohet se borxhi nuk mund të mbledhet, atëherë ai borxh konsiderohet i keq dhe normalisht do të shlyhet nga llogaritë tona përkatëse.

Trajtimi i të ardhurave si një borxh i keq do të jetë faza përfundimtare e procesit të mbledhjes së borxheve të Kompanisë tonë. Për të mbështetur këtë, Kompania zotohet të ndjek 'Procedurën për menaxhimin e borxheve' që është paraqitur në këtë dokument. Qëllimi i Procedurës është të përshkruajë në formë procedurale politikën për përlogaritjen e provizionit dhe shlyerjen e borxheve të këqija. Procedura në fjalë është në përputhshmëri të plotë me legjislacionin e Kosovës.

Për më tepër, Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU), gjatë proceseve të ardhshme të përcaktimit të tarifave për Kompaninë tonë do të merr parasysh përqindjen e mos arkëtimit të të ardhurave, e cila do të burojë nga dosja e menaxhimit të borxheve të këqija të përgatitura nga vetë Kompania bazuar në Procedurën në fjalë.

2. ZBATUESHMËRIA

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e kësaj Politike/Procedure mbetet me Menaxhmentin e lartë ekzekutiv.

Ndërsa, Zyrtari i Lartë Financiar dhe Udhëheqësi për Shërbimin me Konsumatorë do të jenë përgjegjës kryesor për menaxhimin dhe administrimin e Procedurës. Procedura mund të rishikohet në baza vjetore për të siguruar që ajo pasqyron praktikën e tanishme të kontabilitetit dhe është në përputhshmëri me legjislacionin në Kosovë.

Në fund të fund, i gjithë stafi i përfshirë në procesin e faturimit – arkëtimit të të ardhurave, stafi teknik (përgjegjës për ndërprerje të lidhjes dhe për rilidhje) dhe stafi juridik janë përgjegjës për të siguruar që i tërë procesi të shkojë si duhet. Atyre u kërkohet gjithashtu të sigurojnë informacionin dhe dokumentacionin përkatës për çdo proces të mbledhjes së borxheve.

3. DEFENICIONET

“Borxhli”: Një person fizik ose juridik që i detyrohet KRU.

“Borxh i keq”: Një shumë e papaguar e parave që i detyrohet KRU, të cilat nuk janë paguar pavarësisht përpjekjeve të përsëritura për të mbledhur borxhin (që konsiderohet i pariparueshëm) ose është joekonomik të vazhdohet me borxhin.

“Provizionimi i borxhit të keq”: Kjo paraqet provizionimin që bëhet në llogaritë e KRU kundrejt të ardhurave të papaguara të cilat nuk mund të arkëtohen. Ajo siguron që rezultatet e periudhave të ardhshme nuk do të ndikohen negativisht nëse borxhet duhet të shlyhen.

“Shlyerje e borxhit të keq”: Në termin e kontabilitetit “shlyrje” do të thotë që është bërë një rregullim në librat e tatimpaguesit për të reflektuar uljen e vlerës së llogarive të arkëtueshme. Duhet të jetë bërë një rregullim në librat e tatimpaguesit për të pasqyruar shpenzimin aktual të borxhit të keq, duke u bazuar në ato borxhe të veçanta që i plotësojnë kushtet siç janë përcaktuar me ligjislacionin përkatës.

4. PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN E BORXHEVE

Kompania jonë do të jetë e prirur të maksimizojë mbledhjen e parasë së gatshme në shkallë të parë duke ndjekur politikat e rimëkëmbjes së borxheve. Mirëpo, kur edhe përkundër kësaj të ardhurat mbeten të papaguara do të ndiqen procedurat e mëposhtme:

- Procedura për Trajtimin e borxheve më të vjetra se 24 muaj;
[Kjo Procedurë bazohet në politikat e Kompanisë].
- Procedura për Trajtimin e borxheve të vjetra deri në 24 muaj;
[Kjo Procedurë bazohet në politikat e Kompanisë dhe në Ligjin Nr. 05/L-029, për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 24 / 18 gusht 2015)].

PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E BORXHEVE MË TË VJETRA SE 24 MUAJ

ID	PËRSHKRIMI I VEPRIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS
HAPI 1:	Në çdo javë të parë të muajit, Menaxheri rajonal për Konsumatorë dhe Zyrtari i lartë Financiar filtrojnë borxhet sipas shumës më të lartë dhe më të vjetra se 24 muaj për tërë Zonën e shërbimit, por duke shkuar gradualisht, d.m.th. zonë pas zone.	Menaxheri rajonal për Konsumatorë (iniciuesi)

PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E BORXHEVE MË TË VJETRA SE 24 MUAJ

ID	PËRSHKRIMI I VEPRIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS
HAPI 2:	<p>Vendosja për "masat specifike që do të ndërmerren", për të zbatuar mbledhjen e borxhit për konsumatorët e filtruar si borxhlinj të vjetër.</p> <p>Shënim: Ky vendim merret në konsultim me anëtarët e tjerë të Menaxhmentit Ekzekutiv gjatë takimeve të rregullta të menaxhmentit.</p> <p>Masat që do të ndërmerren janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Dërgimi i vërejtjes së dytë; 2) Takimet sqaruese / komunikimet përmes mjeteve të ndryshme komunikuese (tel; e-mail; media; etj.); 3) Ofrimi dhe lidhja e marrëveshjes për pagesë (marrëveshje e lidhur ndërmjet KRU dhe konsumatorit për pagesë të borxhit që ka konsumatori ndaj KRU); 4) Ndërprerja e përkohshme e lidhjes (sipas procedurave të brendshme); 5) Inicimi i procedurës përmbarimore; 6) Inicimi në organet gjyqësore <p>Shënim: Masat janë paraqitur nga ato më të lehtë deri tek ato më vështirë të zbatueshme apo ekonomikisht të pa leverditshme.</p>	Menaxheri rajonal për Konsumatorë
HAPI 3:	Përgatitja e "Planit të veprimeve" për zbatimin e masave të caktuara (si të paraqitura në Hapin 2), sipas rrjedhjes së paraqitur nga 1-5 .	Menaxheri rajonal për Konsumatorë
HAPI 4:	Ekzekutimi i "Planit të veprimeve" dhe raportimi ditor i rezultateve tek Udhëheqësi për çështje komerciale.	Grupi ekzekutues(Udhëheqësit e njësive, zyrtarët për konsumatorë dhe Shefi i Inkasantëve)
HAPI 5:	Raportimi javor i rezultateve dhe diskutimi i hapave të mëtejme me Zyrtarin e lartë	Menaxheri rajonal për Konsumatorë

PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E BORXHEVE MË TË VJETRA SE 24 MUAJ

ID	PËRSHKRIMI I VEPRIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS
	Financiar.	
HAPI 6:	<p>Përgatitja e dosjeve për secilin konsumatorë për mbajtjen e evidencave të marrjes së masave. Dosja duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Kopjen e faturës / vërejtjes së parë; b) Kopjen e vërejtjes së dytë; c) Dëshmitë e komunikimeve; d) Dëshmitë imazhinare (fotot) dhe proces-verbalin e kryerjes së ndërprerjes së lidhjes, kjo e fundit të jetë e nënshkruar edhe nga borxhliu/konsumatori; e) Marrëveshjen për pagesë (sipas Ligjit për fshirjen e borxheve); f) Vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente ose Konkluzionin për mbylljen e procedurës së përmbartimit, që vërtetojnë se borxhi është i (pa) mbledhshëm; g) Çertifikatën nga policia, ose agjencionet e tjera të zbatimit të ligjit për të provuar se borxhliu nuk ka gjurmë; h) Çertifikatën e Zyrës Civile që dëshmon se borxhliu ka vdekur (kjo vlen për rastet kur nuk ka evidencë që prona e borxhliut / konsumatorit nuk trashëgohet bashkë edhe me obligimet e tij/saj nga dikush tjetër. 	Udhëheqësi për çështje komerciale
HAPI 6:	Raportimi (në baza vjetore) në ARRU i arkëtimit sipas vjetërsisë së borxheve.	Zyrtari për raportim

PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E BORXHEVE TË VJETRA DERI NË 24 MUAJ

ID	PËRSHKRIMI I VEPRIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS
	<p>shuma e paguar njihet si e ardhur ndërsa shuma e mbetur e pa-paguar njihet si borxh i keq. Nëse nuk dërgohet kërkesa në fjalë tek kompania likuiduese, ose edhe nuk merren masat tjera të lartë përmendura, atëherë KRU rrezikon që të mos i njihet borxhi i këtij konsumatori si borxh i keq.</p> <p>Shënim: Masat janë paraqitur nga ato më të lehtat deri tek ato më vështirë të zbatueshme apo ekonomikisht të pa leverditshme.</p>	
HAPI 3:	Përgatitja e "Planit të veprimeve" për zbatimin e masave të caktuara (si të paraqitura në Hapin 2), sipas rrjedhjes së paraqitur nga 1-5 .	Menaxheri rajonal për Konsumatorë
HAPI 4:	Ekzekutimi i "Planit të veprimeve" dhe raportimi ditor i rezultateve tek Udhëheqësi për çështje komerciale.	Grupi ekzekutues
HAPI 5:	Raportimi javor i rezultateve dhe diskutimi i hapave të mëtejme me Zyrtarin e lartë Financiar.	Menaxheri rajonal për Konsumatorë
HAPI 6:	<p>Përgatitja e dosjeve për secilin konsumatorë për mbajtjen e evidencave të marrjes së masave. Dosja duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Kopjen e faturës / vërejtjes së parë; b) Kopjen e vërejtjes së dytë; c) Dëshmitë e komunikimeve; d) Dëshmitë imazhinare (fotot) dhe proces-verbalin e kryerjes së ndërprerjes së lidhjes, kjo e fundit të jetë e nënshkruar edhe nga borxhliu/konsumatori; 	Menaxheri rajonal për Konsumatorë

PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E BORXHEVE TË VJETRA DERI NË 24 MUAJ

ID	PËRSHKRIMI I VEPRIMIT	PERSONI PËRGJEGJËS
	<ul style="list-style-type: none"> e) Marrëveshjen për pagesë (sipas kushteve të kompanisë); f) Vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente ose Konkluzionin për mbylljen e procedurës së përbarimit, që vërtetojnë se borxhi është i (pa) mbledhshëm; g) Çertifikatën nga policia, ose agjencionet e tjera të zbatimit të ligjit për të provuar se borxhliu nuk ka gjurmë; h) Çertifikatën e Zyrës Civile që dëshmon se borxhliu ka vdekur (kjo vlen për rastet kur nuk ka evidencë që prona e borxhliut / konsumatorit nuk trashëgohet bashkë edhe me obligimet e tij/saj nga dikush tjetër; i) Konfirmimin nga kompania likuiduese për shumën e borxhit e cila nuk mund të paguhet. 	
HAPI 7:	<p>Shpallja e borxhit të pambledhshëm si borxh i keq dhe intervenimi në kontabilitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëshimi i një faturë të borxhit të keq, në të cilën shënohet "borxh i keq", vlerat përkatëse që korrigjohen, numri rendor, nr. serik, data e faturës së furnizimit me të cilën lidhet ky borxh; - Shlyerja e borxhit të keq sipas kontimit: "shpenzimi i borxhit të keq - ulja e vlerës së llogarive të arkëtueshme". 	Zyrati i lartë financiar
HAPI 8:	Raportimi (në baza vjetore) në ARRU i arkëtimit sipas vjetërsisë së borxheve.	Zyrtari për raportim

5. PROVIZIONIMI (LEJIMI) I BORXHEVE TË KËQIJA

Pas ekzekutimit të 'Procedurës për trajtimin e borxheve të vjetra deri në 24 muaj' për vitin paraprak, Kompania është në gjendje të përcaktojë përqindjen e provizionimit të borxheve të këqija, sipas periudhave të caktuara kohore.

Deri në rishikim të kësaj Politike/Procedure do të shfrytëzohen provizionimet si në vijim:

- Borxhet më të vjetra se 6 muaj provizionohen me 30 %
- Borxhet më të vjetra se 12 muaj provizionohen me 50 %
- Borxhet më të vjetra se 18 muaj provizionohen me 70 %
- Borxhet më të vjetra se 24 muaj provizionohen me 100 %

INTERPRETIMI

Përgjegjësini për përmbajtjen, interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje e mbanë shërbimi financiar i kompanisë.

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të sajë nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Kompanisë, si dhe të publikimit të sajë në Web faqen e Kompanisë.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
Rexhep Manxhuka



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular blue stamp. The stamp contains the text 'KOMANI E DREJTORËVE' at the top, 'PRIZREN' in the center, and 'KRYESUESI' at the bottom. There is also some smaller, less legible text around the perimeter of the stamp.

Prizren
26.10.2018